

VENDIM
Nr. 568, datë 25.8.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 657, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QUKËS – POGRADEC – QAFË-PLLOÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 657, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 15 662 447 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzet e shtatë) lekë...” zëvendësohet me vlerën “16 096 175 (gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë...”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

“4.1 Vlera shtesë e shpronësimit prej 433 728 (katërqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e njëzet e tetë) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.”.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Tabelës bashkëlidhur vendimit nr. 657, datë 8.10.2014, i shtohet edhe tabela, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, si dhe Drejtoria e Miradministritimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 657, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “QUKËS – POGRADEC – QAFË-PLLOÇË”

Nr.	Pronari			ZK	Nr. i pasurisë	Sipërfaqe totale e pronës, m ²	Lloji i pasurisë			VLERA TOTALE (Lek)	Adresa e pronarit	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri				ARË					
							Sip. m2	Çmimi m ²	Vlera në lek			
1	Vasil	Kristaq	Shkira	3627	244/1	4550	2112	192	405,504	405,504	Bashkia Pogradec	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Vasil	Kristaq	Shkira	3627	251/1	1300	147	192	28,224	28,224	Bashkia Pogradec	Konfirmuar nga ASHK-ja
	TOTALI						2259.0		433,728	433,728		